



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 6 Prot.

Tiranë, më 04/01/2018

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 3, datë 04/01/2018

**PËR
PËR NJË SHITESË NË URDHËRIN 73 DATË 21.12.2017 "PËR NISJEN E
PROCEDURAVE PËR NGRITJEN E KËSHILLIT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË
PUNË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të nenit 39, 51 e vijues të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.10 237, datë 18.02.2010 "Ndihma e parë, mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi i punëmarrësve, rreziqet e rënda dhe të menjëhershme", VKM-së nr.107, datë 09.02.2011 "Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të këshillit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit të punëmarrësve", VKM-së nr.108, datë 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", e ndryshuar, nenit 21, të kreut 5, të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë "Ngre komisione dhe grupe pune për çështje, studime dhe veprimtari të veçanta", si dhe në bazë të Relacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mbrojtjen nga zjarri në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme dhe Drejtorisë Juridike të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me propozim të Administratorit të UMT-së dhe në vijim të urdhrin nr.73 datë 21.12.2017,

URDHËROJ:

1. Shtyrjen e afatit të pranimit të kandidatave për punëmarrësit e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pretendues për përfaqësueshmëri në Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë **deri më 11 Janar 2018**.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arkivës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
3. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri Administratori i UMT-së.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**REKTORI
ARBEN GJATA**

